

Milazimit, si dhe disa gjësede personale të tij, në vendin ku ai me shokët kishte rënë në pritë. Ai sot prehet në varrezat e Raushiqit/Raušić. Isa u varros në varrezat e Isniqit/Istinić. Mbetjet mortore të Hilmiut dhe Ramushit janë rivarrosur në vitin 2000 në varrezat e vendlindjes, në fshatin Dubovik. Pas përfundimit të luftës, mbetjet mortore të Naim Gjukajt janë rivarrosur në varrezat e fshatit Strellc i Poshtëm/Donji Streoc.

Trupi i Beqirit nuk është gjetur kurrë. I vëllai e ka gjetur kuletën dhe xhakëtën e tij në vendin ku shqiptarët kishin rënë në pritë. Zhdukja e Beqirit është evidentuar në regjistrin e KNKK-së, në lëndën me numrin rendor BLG-2803259-01.

Burimet: deklarata H.B, FDH-17058; deklarata B.B, FDH-17057; deklarata F.M, FDH-17054; deklarata X.Z, FDH-12896; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832; KNKK, *Persona të zhdukur...*, FDH-9795; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Bashkim (Avdi) Leku

(25.10.1972, shqiptar nga Bajica/Banjica, komuna e Glllogocit/Glogovac, student, pjesëtar i UÇK-së)

Bashkimi ka qenë student i matematikës në Shkollën e Lartë Afariste në Prishtinë/Priština. Ishte aktiv në kundërshtimin e regjimit serb në rajonin e *Drenicës/Drenica*. Policia serbe e kishte kërkuar shumë herë, duke e bastisur shtëpinë e prindërve të tij në Bajicë/Banjica. Ka rënë nga eksplozimi i predhës së tankut më **6.08.1998**, gjatë sulmit të forcave serbe ndaj **Junikut/Junik**. Së pari e varrosën në këtë fshat. Në përvjetorin e rënies së tij, mbetjet mortore të Bashkimit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës, në Bajicë/Banjica.

Burimet: deklarata A.LI, FDH-31824; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; H. Hasani, *Dëshmorët...*, FDH-25596.

Ajne (Osaj Miftar) Zymeraj

(6.10.1936, shqiptare nga Lëbusha/Ljubuša, komuna e Deçanit/Deçani, amvise, gjashtë fëmijë)

Shaban (Ramë) Osaj

(27.05.1932, shqiptar nga Deçani/Deçane, zdrukthëtar, gjashtë fëmijë)

Qaush (Arif) Bajraktari

(18.02.1926, shqiptar nga Deçani/Deçane, kontabilist, pesë fëmijë)

Timë (Dervish Agaj) Bajraktari

(10.02.1928, shqiptare nga Deçani/Deçane, amvise, pesë fëmijë)

Ajnja e moshuar me bashkëshortin Zymerin kanë jetuar në Lëbushë/Ljubuša. Pak para lufte, kanë kaluar në **Deçan/Deçane**, ku e kishin një banesë. Në të njëjtën ndërtesë jetonin edhe Qaushi dhe Timë Bajraktari. Qifti bashkëshortor Zymeraj jetonte vetëm në banesë, pasi që fëmijët e tyre ikën nga lufta në Mal të Zi. Në datën 6.08.1998, Zymeri ka shkuar për disa punë në Pejë/Peć, ndërkaq bashkëshortja e tij ka mbetur në banesë me djalin e axhës, Shabanin. Për vrasjen e Ajnes, Shabanit, Qaushit dhe Timës kanë lajmëruar mediat më **7.08.1998**. Gani Dautaj, të cilin policia e kishte marrë me vete për t'i identifikuar viktimat, u ka thënë më vonë familjarëve të të vrarëve se asnjë nga viktimat nuk ishte vrarë me armë zjarri, por që të gjithë ishin të masakruar. Trupat e të vrarëve policia së pari i ka çuar në morgun e Gjakovës/Đakovica, ndërkaq më vonë i ka transferuar në Pejë/Peć. Ajna, Qaushi, Timja dhe Shabani u varrosën në varrezat e Pejës/Peć më 9.08.1998. Familjarët e Timës dhe Qaushit i kanë rivarrosur mbetjet e tyre mortore në varrezat e Junikut/Junik, më 20.07.2008, ndërkaq varret e Ajnes dhe të Shabanit ende gjenden në varrezat e Pejës/Peć.

Burimet: deklarata D.Z, FDH-17042; deklarata R.I, FDH-12117; deklarata B.B, FDH-29923; KMKRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

Vitomir (Mirko) Kuzmanović

(29.04.1969, serb nga Kamenica e Sremit, pjesëtar i UJ-së)

Vitomiri ka lindur në Tesliq, në Bosnjë e Hercegovinë. Ka marr pjesë në luftërat e Bosnjës dhe Kroacisë. Jetonte si qiraxhi në Rrugën *Slavko Rodić* në Kamenicën e Sremit. Në Ushtrinë e Jugosllavisë ishte i angazhuar si ushtar profesionist, ndërkaq e kishte gradën e togerit të klasës së parë. Kur u dislokua në Kosovë, ka qenë në përbërje të Batalionit të 5 të Policisë Us-